



Republika e Kosovës

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr: 04-351/02-61386

Dt. 22.05.2024

Prizren

DREJTORATI PËR URBANIZËM dhe PLANIFIKIM HAPËSINOR, me kërkesën e **Këshilli Gjyqësor i Kosovës**, me të cilën ka kërkuar leje për ndërtimin e **objektit “Gjykata Themelore ne Prizren” – objekt administrativ** i cili gjendet në rrugën „William Walker”, në kuadër të ngastrës kadastrale nr. **P-71813068-09013-15**, Z.K.Prizren, në bazë të nenit 3 alineja 1 pikat 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5.1, 1.7, 1.16, 1.17. dhe nenit 5 alineja 1 pika 1.2 neni 14 alineja 1. Pika 1.1 nenin 15 alineja 1 pika 1.1, e lidhur me nenin 19. pika 2. të Ligjit për ndërtim numër 04/L-110 si dhe nenit 3. paragrafi 1 pika 1.6, 1.9, 1.12, 1.24, 1.25 dhe nenit 16 të Ligjit për Planifikim Hapësinor numër 04/L-174 të datës 31. 07. 2013, si dhe konform nenit 33 paragrafi 1. Pika 19 të Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha nga Shërbimet dhe Veprimtaritë Komunale numër 01/11-46063 të datës 28. 03. 2019 si dhe Vendimit për përcaktimin e taksës administrative për lëshimin e lejes ndërtimore dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës në territorin e qytetit të Prizrenit numër 01/011-41141 të datës 10. 04. 2014, dhe sipas Vendimit për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit (HZK) për periudhën 2022 – 2030 numër 001-011-48192 datës 31. 03. 2022, e lidhur me nenin 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të neneve 27, 44, 46, 47, 48 si dhe nenit 125, 127 të L. P. P. A. numër 05/031 të datës 25. 05. 2016 merr këtë:

V E N D I M

(për Leje Ndërtimore)

Kjo Leje ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	Këshilli Gjyqësor i Kosovës		
Adresa:	Prizren		
Telefoni:	044//	Emaili:	//

Emri i projektit	“Gjykata Themelore ne Prizren” – objekt administrativ		
Emri i projektuesit	“AGA” , Advanced Group of Architecture, Prishtine		
Adresa:	Prishtine		
Telefoni:	044-//	Emaili:	//

Me këtë Vendim, aplikuesit për leje ndërtimore **Këshilli Gjyqësor i Kosovës** i lejohe ndërtimi i **objektit “Gjykata Themelore ne Prizren” – objekt administrativ, me etazhitet, B+P+4 Z.K. Prizren,** në rrugen “William Walker”pn.//,” nr. **P-71813068-09013-15,** Z.K.Prizren.

	Për punët ndërtimore në vijim	
Adresa:	Rruga “Tirana”pn.	
Zonat (t) Kadastrale	Lokacioni i ndërtimit gjendet në <u>ë Zonën Kadastrale Prizren</u> dhe është i destinuar për ndërtim – <u>Objekt objektit “Gjykata Themelore ne Prizren” – objekt administrativ, B+P+4 Z.K. Prizren.</u> Objekti <u>ndërtimi</u> i objektit në parcelën nr: <u>P-71813068-09013-15,</u> Z.K.Prizren, me sipërfaqe <u>4000m²</u> me dimensione sipas kopjes së planit. Sipërfaqja e <u>bodrumit</u> është: - <u>Brutto S= 1212.00m²</u> Sipërfaqja e <u>përdhesës</u> është: - <u>Brutto S=1074.00m²</u> Sipërfaqja e <u>Katit I-rë</u> është: - <u>Brutto S=1200.62m²</u> Sipërfaqja e <u>Katit II-të deri IV-të</u> është: - <u>Brutto S=1212.00m²</u> Sipërfaqet totale te objektit jane - <u>Brutto S= 30109.37m²</u>	GPS Koordinatat:

Është miratuar taksa administrative për lëshimin e Lejes Ndërtimore në shumën prej **///€**
Parallogaria e vleres se objektit sipas ketij dokumentacioni teknik eshte ne shumen prej **4,880,335.98 €.**

Lloji i ndërtimit të propozuar:		
Ndërtimi i ri ☒	Rindertim ☐	Ripatim ☐
Kategoria e ndertimeve te propozuera:		
Kategoria I ☐	Kategoria II ☒	
A perfshin kerkesa ndryshimin e destinimit? Po ☐ Jo ☒		
Perdorimi i propozuar: objektit <u>objektit “Gjykata Themelore ne Prizren” – objekt administrativ</u>		

Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore **Këshilli Gjyqësor i Kosovës,** me rrugën ne **”William Walker”** i lejohe ndërtimi i objektit - **objektit “Gjykata Themelore ne Prizren” – objekt administrativ, me etazhitet B+P+4.**

Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore. Në rast se nuk fillohet me ndërtim brenda këtij afati atëherë mund të bëhet kërkesa për vazhdim të lejes ndërtimore brenda afatit të vlefshmërisë së lejes ndërtimore;
- Të vendosë tabelen informuese në vendndërtim me informatat e mëposhtme:
 - Informata mbi Lejen Ndërtimore
 - Informatat mbi projektuesin
 - Informata mbi kontraktuesin
 - Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit
 - Të rrethoj vend ndërtimin (punishten)
- Të sigurojë që kontraktuesi në vendndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
 - Një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - Një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të “APROVUAR” nga organi kompetent;
 - Projektin kryesor me të gjitha faza për nevoja të realizimit të ndërtimit;
 - Dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - Librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore;
 - Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
 - Kartelën e miratuar nga Drejtoria e Inspektionit – inspektorati i ndërtimit e cila është e nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
 - Të dorëzoj njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuata dhe mikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga koprojektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveq në rast kur:
 - Ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;

- Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
- Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
- Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.

A r s y e t i m

Aplikuesi **Këshilli Gjyqësor i Kosovës**, ka kërkuar nga organi kompetent **DUPH** lëshimin e Lejes Ndërmimore për **“Gjykata Themelore në Prizren” – objekt administrativ.** Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit, si dhe bazuar në Ligjin për Ndërtim Nr. 04/L-110, Ligjin Nr. 02/L-28 të Procedurës Administrative dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.

- Kjo Leje Ndërmimore bazohet në shqyrtimin e provave:
- Njoftim për plotësim të dokumentacionit **04-353/01-36243 të dt. 27.03.2024**
 - Pëlqimi nga **“KEDS-i”**.
 - Pëlqimi nga **Kom.”Hidroregjioni Jugor”**.
 - Pëlqimi nga **Telekomi i Kosovës – PTK-ja**.
 - Vërtetim nga sektori I menaxhimit të mbeturinave - **Drejtoria e Shërbimeve Publike**.
 - Pëlqimi nga **Kompania Rajonale e Ujitjes – “Dugagjini”**.
 - Pëlqimi nga **Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë**.
 - **Leja Mjedisore Komunale**
 - **Projekti kryesor dhe revidimi i projektit**.

Udhëzimi juridik: pala e pakënaqur me këtë aktvendim, përmes kësaj Drejtorie me ankesë mund t'i drejtohet Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinorë, brenda afatit prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi.

DREJTORIA E URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

Nr.04-351/02-36246, Dt.22.05.2024

Hartoi:

Bashkëpunëtor profesional:

Shpresa Osmanollaj Krapa, inxh.dip.ark.

DREJTORI:

Pranverim Berisha, jur.dip.